

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 57103125

Nr. i fq. / Br. st. 2

Data: / Datum: 30.10.25

VUSHTRRI VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 140/25 30/10/2025

Në bazë të nenit 12, paragrafi 1, pika “d” në lidhje me nenin 24, paragrafi 2, nenit 40, paragrafi 2, pika “b” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 61 i Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, nenit 19.2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 në lidhje me nenin 18 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **24 tetor 2025**, merr këtë:

V E N D I M PËR APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2026 SI DHE PROJEKSIONET PËR VITIN 2027-2028

1. Me këtë vendim aprohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026 si dhe projeksionet për vitet 2027-2028, konform Qarkoreve Buxhetore 01/2026 dhe 02/2026, të lëshuara nga MFPT-ja.

2. Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026 është:
30,291,935.00 € prej të cilave për:

Kategoritë Buxhetore			2026
Paga			15,461,516.00
Mallra dhe shërbime			6,053,280.00
Komunali			670,000.00
Subvencione			2,500,000.00
Shpenzime kapitale			5,607,139.00
TOTALI			30,291,935.00 €

3. Ky buxhet financohet nga grantet qeveritare në vlerë prej **26,464,288.00 €** dhe nga të hyrat vetanake në vlerë prej **3,827,647.00 €**.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me kufijtë buxhetor të dhënë në Qarkoret Buxhetore 01/2026 dhe 02/2026 të lëshuara nga MFPT-së.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Tabela: 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2026-2028; tabela 4.2 – financimi i investimeve kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2026-2028; tabela 4.3 - të hyrat vetanake të komunës për vitet 2026-2028, janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga kuvendi i komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për zbatim.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

